



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1284/2 Prot.

Tiranë, më 09 / 09 / 2019

V E N D I M

Nr. 118 , Datë 09 / 09 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.101, datë 27.08.2019, të D. A, kundër Bashkisë Librazhd², me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak “*gjendjes familjare*”³.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, D. A, në parashtrimet e sjella pranë KMD-së ka pretenduar se gjatë gjithë periudhës së ish-sistemit monist, si dhe në vitet e pas 90-tës dhe aktualisht, është ndjerë i diskriminuar, i poshtëruar si pasardhës i ish-kryeplakut të trevës së Hotolishtit, Zyber Alliu.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Përfshirë dhe Njësinë Administrative Hotolisht si pjesë përbërëse të saj.

³ Gjatë parashtrimeve rezulton se, ankuesi i referohet këtij shkak duke argumentuar lidhjet e tij familjare, si stërnip i z.Z. A, vvarë me datë 23.09.1943. (citim i ankuesit)

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi ka pretenduar se, diskriminimi i tyre lidhet me faktin se Shkolla e Mesme e Bashkuar e Njesisë Administrative Hotolisht (ish-Komuna Hotolisht) vijon të mbajë që nga viti 1950 kur është krijuar, dhe deri aktualisht emërtimin “Rahman Çota”, një emër i pamërituar ky, pasi ankuesi pretendon se ai ka qenë një vrasës ordiner, i cili me datë 23 Shtator 1940, ka vrarë në një pusi gjyshin e tij, Zyber Alliu, i cili njihej si person i arsimuar, bamirës, patriot e atdhetar.

Në vijim ai citon se: *“Ndjehemi të diskriminuar si nipër, stërnipër të Zyber Ali Allit pasi ne kemi mbaruar shkollën aty dhe dëftesat e marra i kemi të nëshkruara nën logon, emrin e vrasësit të gjyshit, stërgjyshit tonë, i cili ishte kryeplak i trevës së Hotolishtit. Argumenti i përdorur nga instancat shtetërore se Rahman Çota ka rënë dëshmor në fushëbetejë, kundër pushtueve fashisto-nazistë dhe ballistëve është i pavërtetë dhe krejtësisht mashtrim për faktin se ai ka patur të kaluar kriminale, banditeske. Sipas të dhënave dhe informatave që kemi siguruar, është e vërtetë që ky person ka vdekur gjatë luftës nga plagë të shkaktuara nga armë zjarri, mirëpo këto plagë në trupin e tij, nga të cilat gjeti vdekjen, nuk ia shkaktuan armët dhe plumbat e pushtuesve, por këto plagë vdekjeprurëse i shkaktoi ai vetë me armët e tij, nga padituria apo pakujdesia. Për këtë gjë nuk mund të japim ndonjë vesion përfundimtar, por për këtë mund të deklarohe vetëm bashkëmoshatarët dhe bashkëluftëtarët e tij, që kanë qenë prezent në atë ngjarje. Rahman Çota bashkë me vëllanë Ymer Çota dhe kushëririn e tij, me datë 23 Shtator 1940 ftuan në pusi dhe e vranë pabesisht Zyber Alliu.*

...Banorët e Librazhdit mund të jenë informuar nga paraardhësit, familjarët e tyre më të moshuar për këtë vrasje kriminale-banditeske, të pabesë, në pusinë e ngritur me datë 23 Shtator 1940”.

Në përfundim të ankesës së tij, D. A kërkon që Komisioneri, t’i kërkojë Bashkisë Librazhd heqjen e emrit të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Rahman Çota” të Njesisë Administrative Hotolisht dhe vendosjen e një emëri/emërtimi tjetër të merituar dhe dinjitoz.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Subjekti ankues e lidh pretendimin e tij për diskriminim me faktin që Shkolla e Mesme e Bashkuar e Njësisë Administrative Hotolisht mban emrin “Rahman Çota”, për të cilin ai shprehet se nuk e meriton statusin e Dëshmorit të Atdheut, pasi ka qenë kriminel dhe vrasës i gjyshit të tij Zyber Alliu. Citimet e ankuesit janë thjesht deklarative sa i takon dyshimeve të tij dhe informacioneve që ai mund të ketë grumbulluar në mënyrë individuale nëpërmjet bisedave me persona të ndryshëm.

Lidhur me këtë pretendim, i cili përbën dhe thelbin e ankesës, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk ka sjellë asnjë dokument apo provë shkresore për të dokumentuar faktin se Rahman Çota është vrasësi i Zyber Alliu, dhe për më tepër që titulli “Dëshmor i Atdheut” t’i jetë dhënë padrejtësisht, pasi ky është një titull/status që jepet nga institucione dhe instanca të posaçme, dhe gjithë procedura ka qenë e parashikuar dhe rregulluar me legjislacionin specifik të periudhës kur i është akorduar ky titull⁵.

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se ai ka patur dijeni lidhur me emërtimin e kësaj shkolle, të

⁵ Ligji nr.109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 7 të tij, “Dëshmorët e shpallur me vendime të organeve shtetërore të mëparshme”, ka përcaktuar se: *“Të gjitha dekretet/vendimet e organeve shtetërore për shpalljen “Dëshmor”, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë objekt rishikimi nga ky ligj”.*

paktën që nga viti 2010 që ka hyrë në fuqi ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, *ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 27.08.2019*⁶, pra më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, ankesa e D. A, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç/dh të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së D. A, për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm, për të bërë të mundur një hetim, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe janë tejkualuar afatet ligjore sipas këtij ligji.

⁶ Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha : Të mira dhe Shërbime

Shkaku: Gjendja familjare